



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**



---

**S T A T U T I**  
**I**  
**TEATRIT TË QYTETIT TË PRISHTINËS "DODONA"**

Prishtinë, prill 2013

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika d dhe të nenit 14, paragrafi 14.1 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), të dispozitave të nenit 5, pika 1.1 të Ligjit nr. 04/L - 106, për teatrot ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 18/03, korrik 2012), të dispozitave të nenit 34, pika 34.1, shkronja a të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.2.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 11.04.2013, miratoi këtë

**S T A T U T  
TË  
TEATRIT TË QYTETIT TË PRISHTINËS "DODONA"**

## I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

### Qëllimi

#### Neni 1

Më këtë Statut rregullohet statusi i teatrit të qytetit të Prishtinës "Dodona", (në tekstin e mëtejmë: "teatri"), themelimi, organizimi, funksionimi, drejtimi, udhëheqja, financimi, planifikimi, transparenca dhe çështje të tjera të rëndësishme për teatrin.

#### Neni 2

Për realizimin e të drejtave dhe përgjegjësive që i takojnë teatrit, teatri vepron në pajtim me dispozitat e Ligjit për teatrot, këtë Statut dhe vendimet, të cilat i miraton Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

## II. STATUSI I TEATRIT

#### Neni 3

1. Teatri është themeluar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, nr. 110 - 28/86 - 01, të dt. 12.11.1986;
2. Në pajtim me regjistrimin e teatrit, nr. 80225164, të datës 27.09.2000 dhe në bazë të dispozitave të Ligjit për teatrot, teatri ka vazhduar punën - veprimtarinë e tij;
3. Sipas dispozitave të nenit 4 të Ligjit për teatrin që është në fuqi, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 26.2.2013, ka miratuar Vendimin për vazhdimin e punë së teatrit të qytetit të Prishtinës "Dodona", si institucion kulturor dhe arsimor, me të drejta dhe përgjegjësi të parapara me Ligjin për teatrot.

#### Neni 4

Selia e teatrit është në Prishtinë, rruga "Xhavit Mitrovica", pa numër.

#### Neni 5

1. Emërtimi i teatrit është: "Teatri i qytetit të Prishtinës "Dodona" Prishtinë";

2. Teatri ka status të personit juridik, me të drejta dhe përgjegjësi që i takojnë me ligj, Statut dhe vendime të Kuvendit të Komunës së Prishtinës;
3. Pasuria e teatri është pronë e Komunës;
4. Teatri përdor xhirollogarinë për qarkullim finansiar;
5. Në hyrje të objektit të teatri vendoset mbishkrimi në gjuhët zyrtare, të cilat parashihen me Ligjin për përdorim të gjuhëve.

#### Neni 6

1. Teatri ka vulën e rrumbullakët dhe vulën katrore.
2. Vula e rrumbullakët është me diametër 2.5 cm dhe ka këtë përmbajtje:

- a) Rrethi i parë: *Republika e Kosovës*;
- b) Rrethi i dytë: *Komuna e Prishtinës*;
- c) Rrethi i tretë: *TQP "Dodona"*;
- d) Në mes të vulës është *emblema - logoja e Komunës*.

3. Vula katrore, e pranimit dhe e dorëzimit, është e madhësisë 6 x 2.5 cm, me përmbajtje:
  - a) *Republika e Kosovës*;
  - b) *Komuna e Prishtinës*;
  - c) *TQP "Dodona"*;
  - d) *Njësia organizative, numri dhe data*.

### III. VEPRIMTARIA E TEATRIT

#### Neni 7

Në kuadër të teatrit kryhen këto veprimtari:

- a) përgatitja e shfaqjeve teatrore për fëmijë, të rinj dhe të rritur;
- b) përgatitja e shfaqjeve me kukulla për të veglit;
- c) publikimi i veprave teatrore, veprave letrare dhe veprave muzikore që kontribuojnë në përparimin e veprimtarisë teatrore;
- d) mbajtja dhe ruajtja e dokumentacionit teatror;
- e) botimi i monografive nga lëmi i krijimtarisë skenike dhe kulturore;
- f) dhënia e iniciativës për nxjerrjen e dispozitave dhe marrja e masave të tjera lidhur me zhvillimin e veprimtarisë teatrore;
- g) ndërmarrja e veprimeve të tjera lidhur me zhvillimin e veprimtarisë teatrore në përgjithësi, e veçmas për të rinj dhe fëmijë;
- h) organizimi i ekspozitave lidhur me veprimtarinë teatrore;
- i) hartimi i programeve dhe katalogëve lidhur me veprimtarinë teatrore të të rinjve dhe fëmijëve;
- j) organizimi i festivaleve.

- k) kryerja e punëve të tjera të parapara me ligj.

#### **IV. STRUKTURA E TEATRIT**

##### **Neni 8**

Struktura drejtuese e teatrit është në këtë përbërje:

- a) drejtori;
- b) Këshilli drejtues dhe
- c) udhëheqësi artistik.

##### **Neni 9**

Drejtori i teatrit, përveç kushteve të përgjithshme të parapara me ligj, duhet të ketë edhe përgatitje superiore profesionale dhe së paku 3 vjet përvojë pune në fushën relevante.

##### **Neni 10**

1. Drejtorin e teatrit, në procedurë të konkursit publik, sipas propozimit të Komisionit intervistues, e emeron Këshilli drejtues i teatrit, në kohëzgjatje për periudhën katër (4) vjeçare.
2. Në kushte dhe procedurë të caktuar ligjore, Këshilli drejtues i teatrit mund ta shkarkojë drejtorin edhe para periudhës për të cilën është emëruar.

#### **Drejtori i teatrit të qytetit**

##### **Neni 11**

#### **Drejtori i teatrit:**

- a) bën udhëheqjen financiare, administrative, teknike dhe promovuese të teatrit;
- b) zbaton propozimet e Këshillit drejtues të teatrit;
- c) propozon organizimin e brendshëm të teatrit;
- d) përfaqëson teatrin brenda dhe jashtë vendit;
- e) propozon politikat e zhvillimit të teatrit dhe politikat për mbështetje financiare;
- f) propozon buxhetin vjetor për teatër;
- g) kërkon, aplikon dhe negacion për marrjen e donacioneve;
- h) negacion dhe nënshkruan kontrata dhe marrëveshje për artistë të pavarur dhe të tjerë;
- i) udhëheqë me mirëmbajtje dhe sigurinë e ndërtësës së teatrit;
- j) bashkëpunon me teatrot tjera në nivel vendi dhe ndërkombëtar;
- k) për punën e tij, i përgjigjet Këshillit drejtues të teatrit dhe drejtorit të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- l) Kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj, këtë statut dhe akte të tjera të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës.

#### **Këshilli drejtues i teatrit**

##### **Neni 12**

1. Këshilli i drejtues i teatrit përbëhet prej pesë (5) anëtarëve, të cilët duhet të janë persona

me autoritet, me autoritet dhe me përgatitje profesionale në fushën e teatrit, të kulturës, të rinisë dhe të arsimit;

2. Mandati i Këshillit drejtues të teatrit është katër (4) vjeçar;
3. Njëri nga 5 anëtarët të Këshillit drejtues, duhet të jetë përfaqësues i Komunës;
4. Anëtarët e Këshillit drejtues të teatrit i emëron dhe i shkarkon Kryetari i Komunës;
5. Çështjet që kanë të bëjnë me konstituimin e Këshillit, mbajtjen e mbledhjeve, votimin dhe çështjet tjera me rëndësi, rregullohen me akt të veçantë;
6. Këshilli drejtues:
  - a) mbikëqyrë punën e teatrit;
  - b) miraton politikat afatgjatë të zhvillimit të teatrit dhe politikën artistike;
  - c) miraton planin vjetor buxhetor të teatrit, me propozim të drejtorit të teatrit;
  - d) miraton programin artistik vjetor të teatrit, me propozim të udhëheqësit artistik dhe në përputhje me buxhetin vjetor;
  - e) shqyrton dhe miraton raportin vjetor financiar të teatrit;
  - f) harton dhe propozon Statutin, rregulloret dhe aktet tjera nënligjore të teatrit, të cilat i miraton Kuvendi i Komunës së Prishtinës;
  - g) interviston kandidatët dhe zgjedh drejtorin dhe udhëheqësin artistik të teatrit;
  - h) nis procedurën dhe bënë shkarkimin e drejtorit dhe udhëheqësit artistik;
  - i) kryen punë dhe detyra të tjera të përcaktuara me ligj, këtë statut dhe me vendime të Kuvendit të Komunës së Prishtinës.

7. Anëtarët e Këshillit drejtues të teatrit i përgjigjen dhe i raportojnë Kryetarit të Komunës për punën e tyre;

8. Anëtarët e Këshillit drejtues kompensohen për punën e tyre. Forma dhe shuma e pagesës caktohet sipas legjisacionit në fuqi.

### **Udhëheqësi artistik**

#### **Neni 13**

Udhëheqësi artistik i teatrit, përveç kushteve të përgjithshme për emërim, të parapara me ligj, duhet të ketë edhe përgatitje superiore profesionale nga lëmi i dramës ose i regjisë dhe së paku 3 vjet përvojë pune në fushën relevante.

#### **Neni 14**

1. Udhëheqësin artistik të teatrit, në procedurë të konkursit publik, sipas propozimit të Komisionit intervistues, e emëron Këshilli drejtues i teatrit, në kohëzgjatje për periudhën katër (4) vjeçare.
2. Këshilli Drejtues i teatrit, në kushte dhe procedurë të caktuar ligjore, mund ta shkarkoje udhëheqësin artistik edhe para periudhës për të cilën është emëruar.

#### **Neni 15**

Udhëheqësi artistik i teatrit ka këto përgjegjësi:

- a) propozon politikat artistike të teatrit dhe i zbaton ato pas miratimit nga ana e Këshillit drejtues të teatrit;
- b) në konsultim me drejtorin, bën propozimin e repertorit artistik vjetor para Këshillit drejtues të teatrit;
- c) udhëheq punën kreative të ansamblit;
- d) bën recension për çdo vepër skenike para hyrjes në repertorin vjetor të teatrit;
- e) përcakton regjisoret dhe i ndihmon drejtorit në përgjedhjen e ekspit artistik të shfaqjeve;
- f) i propozon drejtorit për bashkëpunim artistik me artistë dhe institucionet teatrore;
- g) mban përgjegjësi për çdo shfaqje publike të teatrit;
- h) për punën e tij e njofton drejtorin, por i përgjigjet dhe i raporton Këshillit drejtues të teatrit.

## V. ORGANIZIMI I BRENDSHËM

### Neni 16

1. Teatri veprimtarinë e vet e realizon përmes njësive organizative – sektorëve;
2. Sektorët e teatrit janë:

- a) Sektori i dramës;
- b) Sektori për fëmijë;
- c) Sektori i kukullave dhe
- d) Sektori i punëve të përbashkëta.

16.3. Teatri, me propozimin e Këshillit drejtues, mund të themelojë sektorë, sipas kërkesave, mundësive buxhetore dhe kritereve te përcaktuara me ligj;

16.4. Me aktin për organizim të brendshëm të teatrit, rregullohen: organizimi, kompetencat dhe përgjegjësitë e njësive - sektorit.

## VI. FINANCIMI I TEATRIT

### Neni 17

1. Mjetet për punën e teatrit për program, shpenzime materiale, paga dhe mëditje, mjete për investime kapitale dhe investime për mirëmbajtje, duhet të sigurohen në përputhje me ligjin, në bazë të propozimit të pranuar të planit dhe programit financiar.
2. Mjetet për punën e teatrit i siguron Komuna e Prishtinës.
3. Mjetet financiare për punën e teatrit mund të sigurohen edhe nga:

- a) të hyrat vetanake,
- b) donacionet, sponsorët,
- c) si dhe burimet tjera, në përputhje me ligj.

## VII. PLANI DHE RAPORTI I PUNËS

### Neni 18

Drejtori i teatrit harton planin e punës dhe reportin për punën e bërë. Plani i punës dhe raporti i punës i dërgohet Këshillit drejtues për miratim për çdo vit.

### Neni 19

Drejtori i teatrit planin e punës e harton në pajtim me qëllimet për të cilat është themeluar, posaçërisht për vëllimin dhe cilësinë e shërbimeve të kryera nga teatri.

## VIII. AKTORËT E TEATRIT

### Neni 20

1. Teatri ka ansamblet artistike, me përbërje nga të gjitha gjeneratat;
2. Aktorët e angazhuar në teatër duhet të kenë shkollimin adekuat akademik;
3. Ansamblin artistik e përzgjedh komisioni profesional i përbërë nga 5 anëtarë;
4. Komisionin profesional e zgjedh këshilli drejtues i teatrit nga lista e propozuar e udhëheqësit artistik;
5. Çështjet tjera për aktorët e teatrit janë të parapara me dispozitat e nenit 16 të Ligjit për teatrot që është në fuqi.

## IX. PUNONJËSIT TJERË TË TEATRIT

### Neni 21

1. Teatri ka stafin administrativ dhe teknik;
2. Përgjegjësitë, detyrat, të drejtat dhe numrin e punonjësve teatri e përcakton me akt të brendshëm.

## X. NJOFTIMI I PUNONJËSVE, TRANSPARENCA DHE SEKRETI ZYRTAR

### Njoftimi i punonjësve

### Neni 22

Njoftimi i punonjësve bëhet:

- a) përmes publikimit të vendimeve të marra në tabelën e shpalljeve të teatrit dhe
- b) në bazë të kërkesës së secilit punonjës, në mënyrë që t'i jepen shënimet e kërkua lidhur me realizimin e të drejtave dhe përgjegjësive të tij.

### Transparenca dhe sekreti zyrtar

### Neni 23

1. Puna e teatrit është transparente për publikun;
2. Transparenca për punën e teatrit realizohet përmes:

- a) organizimit të shfaqjeve dhe festivalave teatrale,
- b) bashkëpunimit me institucionet dhe organizatat në lëmin e teatrit, shkencës, arsimit dhe kulturës;
- c) ueb - faqes zyrtare.

#### **Neni 24**

Drejtori i teatrit është i autorizuar që të japë njoftim me shkrim dhe njoftim përmes shtypit, radios dhe TV – së pér çështjet që kanë të bëjnë më punën e teatrit.

#### **Neni 25**

Sekret zyrtar në teatër konsiderohet dokumentacioni dhe shënimet, transparenca e të cilave do të ishte në kundërshtim me interesat e teatrit, dhe të Komunës si themeluese. Sekret zyrtar do të trajtohet dokumentacioni dhe shënimet, të cilat janë paraparë me vendim të veçantë të Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

### **XI. MBROJTA DHE TË DREJTAT E PUNONJËSVE**

#### **Neni 26**

Realizimi i të drejtave të punonjësve, bëhet duke u bazuar në dispozitat e ligjeve në fuqi që rregullojnë mbrojtjen dhe të drejtat e tyre.

### **XII. AKTET E TQP “DODONA”**

#### **Neni 27**

1. Këshilli drejtues i teatrit duhet të hartojë aktet të tjera për zbatim të Statutit, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës;
2. Aktet e cekura në pikën 1 të këtij neni, duhet të nxirren në afat prej 3 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij statuti;
3. Aktet e miratuara publikohen në tabelën e shpalljeve të teatrit dhe ueb - faqen e teatrit.

### **XIII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 28**

Nga dita kur hyn në fuqi ky statut, pushon të vlefjë Statuti i teatrit të qytetit të Prishtinës “Dodona”, i miratuar në Kuvendin e Komunës, 01 nr. 110 - 154, dt. 27.01.2011.

#### **Neni 29**

Ky Statut hyn në fuqi 8 ditë nga dita e publikimit të tij në tabelën e shpalljeve dhe në ueb - faqen e Komunës së Prishtinës.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

**01. nr. 110-50578, më 11.04.2013**

**KRYESUESI I KUVENDIT TË KOMUNËS**

**Sami Hamiti, ecc. i dipl.**

